



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

MARRËVESHJE



E lidhur sot më datë 12.06.2025, mes palëve:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS J62027011I, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.2, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Roland Kristo,
2. Universitetit Bujqësor i Tiranës , me adresë Rruga “Pajsi Vodica”, Kodër - Kamëz, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku.

Kjo Marrëveshje bazohet në dispozitat ligjore në fuqi të Kodit të Procedurës Administrative, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Kontratës së Shërbimit “Për Identifikimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA) në Ujërat e Brendshme”, Nr. 5104/1 prot., datë 6.10.2022.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësuar nga Zëvendësministri Z. Roland Kristo dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës përfaqësuar nga Prof.Dr Fatbardh Sallaku kanë lidhur Kontratën e Shërbimit “Për Identifikimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA) në Ujërat e Brendshme”, Nr. 5104/1 prot., datë 06.10.2022 dhe Nr.907/3 datë 06.10.2022.

Referuar gjetjeve nga monitorimi dhe verifikimi i kontratës prej grupeve të punës të mëparshme, rezulton se pranë MBZHR-së, nga ana e UBT nuk është paraqitur studimi përfundimtar sipas afatit të përcaktuar në kontratë. Bazuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës së Shërbimit, pika 7/2, afati i dorëzimit të studimit është përcaktuar data 30.6.2023, por si rezultat i mosrespektimit të këtij afati, jemi në kushtet e parashikimeve të pikës 7.4 të Kontratës të cilat përcaktojnë “*Shkelja dhe mosrespektimi i afateve, ndëshkohet me sanksione siç janë specifikuar në zërat përkatës të kontratës*”, si dhe referuar nenit 13 “*Reklamimet*” citon “*Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për dorëzimin e raporteve teknike e financiare pjesore dhe përfundimtare, në MBZHR, penalizohet me 4/1000 e vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë*”.

Sqarojmë se si shkak i vonesës prej 132 ditë kalendarike për dorëzimin e materialit, referuar llogaritjeve të detajuara në Memo-n e grupit të punës Nr.3681/2 prot., datë 11.06.2024 drejtuar Z. Roland Kristo, “Informacion mbi vlerësimin e Raportit Përfundimtar të studimit mbi

“Identifikimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Ujërat e Brendshme të Republikës së Shqipërisë”, shuma për t’u paguar në favor të UBT është 23,686 lekë.

Duke qënë se në buxhet nuk ka argument për riçelje financimi për këtë projekt (gati një vit nga data e mbylljes së tij,) e duke theksuar se shumica e vonesave janë shkaktuar nga menaxhimi financiar i sipërmarrësit, palët bien dakort për mospagesë të mëtejshme të kësaj shume, pasi kjo i takon kryesisht fitimit të palës kontraktore si dhe në zbatim të nenit 25 të Kontratës “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”.

Studimi është marrë në dorëzim nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhërin e Ministrit Nr. 574, datë 02.12.2022 dhe nga teknikët e fushës është cilësuar si i pranueshëm/vlefshëm edhe pse pa oponencën përkatëse. Ky studim do të bëhet hyrje në MBZHR me vlerën prej **1,312,203** lekë, që korresponon me shumën që MBZHR ka paguar në favor të UBT-sw , sipas kushteve të kontratës.

Palët e cituara, të cilat përfaqësojnë juridikisht institucionet kontraktuale MBZHR dhe UBT, deklarojnë se lidhin këtë Marrëveshje me vullnet të lirë sipas parimeve të transparencës dhe ligjshmërisë, si dhe marrin përsipër të respektojnë kushtet e rrethanat e përcaktuara në të pa pretendime dhe kontestime të tjera në të ardhmen.

Për

Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Zv. Ministri Roland Kristo

Sekretar i Pergjithshem

Z. Dritan Palnikaj

Për

Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektor

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku

Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit

Prof.Asoc Rigers Bakiu

Prof. Asoc. Jerina Kolutari





UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12/06/2025, në ambjentet e Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në prezencë të Grupit të Punës për monitorimin e kontratës së shërbimit “Për identifikim e zonave të përcaktuara për akuakulturë ZPA në ujërat e brendshme” me titull “Studimi mbi identifikim e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Ujërat e Brendshme të Republikës së Shqipërisë” me përbërje z. Arjan Demiri, znj. Adra Gjongecaj, znj. Alsiva Bazaj, i krijuar me urdhër të titullarit të MBZHR-së, nga njëra anë dhe Përfaqësuesve të kontraktorit Universiteti Bujqësor i Tiranës, Prof.Asoc. Rigers Bakiu, Prof. Asoc. Elvira Beli, Prof. Asoc. Edmond Hala, Prof. Asoc. Jerina Kolutari, Msc. Elvis Kamberi, Dr. Enkelejda Buda dhe Dr. Marsida Bllaca.

Referuar rezultateve të nxjerra nga monitorimi i kontratës nga të dyja grupet e punës, dhe nga verifikimi rezultoi se pranë MBZHR-së, nga UBT nuk është paraqitur studimi përfundimtar në afatin e përcaktuar në kontratë. Bazuar në kushtet e veçanta të kontratës së shërbimit, pika 7/2, afati i dorëzimit të studimit është përcaktuar data 30.6.2023, por si rezultat i mosrespektimit të këtij afati, e referuar pikes 7.4 “Shkelja dhe mosrespektimi i afateve, ndëshkohet me sanksione siç janë specifikuar në zërat përkatës të kontratës”, e specifikisht në nenin 13 “Reklamimet shprehet se “Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për dorëzimin e raporteve teknike e financiare pjesore dhe përfundimtare, në MBZHR, penalizohet me 4/1000 e vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë”.

Duke konideruar vonesën prej 132 dite kalendarike për dorëzimin e materialit, bazuar llogaritjeve të detajuara në Memo-n e grupit të punës Nr.3681/2 prot., datë 11.06.2024 drejtuar Z. Roland Kristo, “Informacion mbi vlerësimin e Raportit Përfundimtar të studimit mbi “Identifikimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Ujërat e Brendshme të Republikës së Shqipërisë”, shuma për t’u paguar në favor të UBT është 23,686 lekë. Duke qënë se shifra është e papërfillshme, krahasuar me vlerën totale të kontratës, dhe në buxhet nuk ka argument për riçelje financimi për këtë projekt (gati një vit nga data e mbylljes së tij), e duke theksuar se shumica e vonesave janë shkaktuar nga menaxhimi financiar i sipërmarrësit, palët bien dakort për mospagesë të mëtejshme të kësaj shume, pasi kjo i takon kryesisht fitimit të palës kontraktore.

Duke qënë se studimi është marrë në dorëzim nga grupi i parë i monitorimit, i ngritur me urdherin e ministrit nr.574, datë 2.12.2022, edhe pse pa oponencën përkatëse, nga teknikët e fushës është cilësuar si i pranueshëm/vlefshëm, pasi mungonte një studim i mirëfilltë në akuakulturën e ujrave

të brendshme, edhe pse studimi ka nevojë të përhershme për përditësime dhe nuk mund të ketë karakter shterues, pasi është proces dinamik. Ky studim do të bëhet hyrje në MBZHR me vlerën prej 1,312,203 lekë, që korespondon me shumën që MBZHR ka paguar në favor të UBT, sipas kushteve të kontratës.

Bazuar nenit 18 të kushteve të veçanta të kontratës “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”, ky procedverbal midis palëve po mbahet për të dakortësuar dhe për të mos patur pretendime të mëtejshme lidhur me detyrimet dypalëshe, që rrjedhin nga kontrata.

Ky Procesverbal po mbahet dhe firmoset në 5 kopje, nga të dyja palët e përfshira në kontratë, duke shuar çdo lloj kërkese apo pretendimi të mëtejshëm, që rrjedh nga kontrata.

Për

**MINISTRINË E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

Zv. Roland KRISTO

SEKRETAR I PERGJITSHEM

Z. Dritan PALNIKAJ

ANËTAR

Grupi i punes:

Z. Arjan DEMIRI

Znj. Adra GJONGECAJ

Znj. Alsiva BAZAJ (*me leje lindje*)

Për

**UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË
TIRANËS**

REKTOR

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



KRYETAR

Prof. Asoc. Rigers BAKIU

Prof. Asoc. Elvira BELI

Prof. Asoc. Edmond HALA

Prof. Asoc. Jerina KOLITARI

Msc. Elvis KAMBERI

Dr. Enkelejda BUDA

Dr. Marsida BLLACA